

e ka varrosur Isufin në oborrin e shtëpisë. Pas përfundimit të luftës, më 15.08.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Isufit në varrezat lokale.

Burimi: deklarata H. B, FDH-17902.

Dušan (Petar) Urošević

(13.02.1967, serb nga Beogradi, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Dušani e kishte të mbaruar shkollën e mesme mekanike *Petar Drapšin* në Beograd, si dhe kursin për oficer policie. Në vitin 1998 u punësua në Shërbimin e Sigurimit Shtetëror pranë MPB-së së Serbisë. U vra gjatë luftimeve me pjesëtarët e UÇK-së, që u zhvilluan më **31.05.1998** në **Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg**. U varros në Beograd më 2.06.1998.

Burimet: KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 72; KMDLNI, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 196, FDH-23816; *Dnevnik od 25. maja do 1. juna*, Ilustrova politika, nr. 2055, FDH-16958; SMIP, *Terroristički...*, III, 933; *Pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme – viktimat e terrorizmit shqiptar në vitin 1998*, na <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html> , FDH-31078.; *Kosovo refugees describe ethnic cleansing*, Lodi News Sentinel, 3.06.1998, FDH-31179.

Vidosava (Simon) Simić

(10.02.1932, serbe nga Lloqani/Loçane, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, katër fëmijë)

Që nga vdekja e bashkëshortit, Vidosava jetonte vetëm në **Lloqan/Loçane**. Diku në pranverë të vitit 1998, te ajo ka kaluar motra Borka, e cila ishte person me nevoja të veçanta. Kur serbët vendosën të braktisnin fshatin në prill të vitit 1988, Vidosava vendosi që të rrinte me motrën. Në datën **31.05.1999**, përderisa punonte në oborrin e vet, ajo u qëllua nga një pushkë snajperi. Është varrosur në varrezat e Deçanit/Deçane nga ushtaret e UJ-së, të cilët ato ditë ishin të pozicionuar në fshat.

Burimet: deklarata B.M, FDH-31769; deklarata M.J, FDH-546; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Terroristi muçili ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.09.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>.

Idriz (Zeqë) Tolaj

(1936, shqiptar nga Pobërgja/Pobrde, komuna e Deçanit/Deçane, punëtor ndërtimor, pesë fëmijë)

Forcat serbe u pozicionuan përreth fshatit **Pobërgjë/Pobrde** më **31.05.1998**. Fshatarët, në mesin e tyre edhe familja e Idrizit, i braktisën menjëherë shtëpitë e veta, por Idrizi nuk desh të largohej nga fshati. Familjarët e tij, të cilët u strehuan në fshatin Jabllanicë/Jablanica, dëgjuan se forcat serbe, të njëjtën ditë, e kishin kryer sulmin ndaj fshatit të tyre. Për Idrizin nuk kishin kurrfarë njohurish. Pas kthimit në shtëpi, në përfundim të luftës në fund të qershorit të vitit 1999, Idrizin nuk e gjetën në shtëpi. Kanë bërë shumë kërkime për të mësuar fatin e tij, por pa sukses. Për Idrizin as sot nuk dihet asgjë. Zhdukja e tij është e regjistruar nga KNKK-ja dhe rasti i tij e mban numrin rendor BLG-803312-01.

Burimet: deklarata C.T, FDH-18706; deklarata G.T, FDH-12375; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Beqir (Rexhë) Cacaj

(1938, shqiptar nga Deçani/Deçane, punëtor, gjashtë fëmijë)

Beqiri e kishte shtëpinë në hyrje të **Deçanit/Deçane**, nga drejtimi i Pejës/Peç. Aty jetonte me familjen. Në datën 28.05.1998, ai me bashkëshorten Cymen, vëllain Xhemajlin, bashkëshorten e tij dhe disa familje të tjera nga rruga e tij u tubuan në oborrin e Qazim Kuçit, nga ku dëshironin të braktisnin qytetin së bashku. Por, së shpejti ka arritur policia serbe, i ka arrestuar dhe i ka dërguar në stacionin policor. Pas gjysmë ore, policia ka urdhëruar që të gjithë të shkonin në shtëpinë e Sylë Cacajt [i afërm i Beqirit dhe i Xhemajlit], e cila ndodhej afër stacionit policor. Ditën tjetër, në këtë shtëpi erdhi një grup policësh serb. E kanë bastisur shtëpinë. Pastaj i kanë çuar banorët e saj në stacionin policor, përpos prindërve të moshuar të Sylës. Të nesërmen, më 30.05.1998, herët në mëngjes, e kanë marr Beqirin për bisedë informative. E kthyen pas dy orësh tërësisht të mavijosur nga